



Bazuar në nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nenin 21, paragrafi 1 dhe nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit nr.03 / L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 16, paragrafi 1, të Ligjit Nr.04 / L-155 për Sistemet e Pagesave, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 prill 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR HUADHËNIE BRENDA-DITORE DHE NJËDITORE

Neni 1

Qëllimi dhe Fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë kushtet dhe kriteret sipas të cilave Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mund të ofrojë hua të kolateralizuar brenda-ditore dhe hua njëditore për likuiditet për bankat e kualifikuara. Qëllimi i këtyre dy lehtësirave për likuiditet është t'i mundësojë BQK-së të kryejë operacionet me bankat e kualifikuara dhe të sigurojë një funksionim të sigurt të sistemit të shlyerjes së pagesave ndërbankare.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK për të vepruar në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termet e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit nr.04/L-093 për Banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare dhe / ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Huadhënie e kolateralizuar** - nënkupton një hua afatshkurtër të ofruar nga BQK për bankat e kualifikuara kundrejt pengut në formë të letrave me vlerë të Qeverisë;
 - 1.2. **Bankë e kualifikuar** - nënkupton një bankë ose degë të një banke të huaj e cila është e licencuar nga BQK për të operuar në Kosovë, është pjesëmarrëse dhe posedon llogari me sistemet SRK dhe SPN të operuar nga BQK, dhe ka nënshkruar një Marrëveshje të Përgjithshme të Riblerjes me BQK-në, si dhe zotëron kolateralin e kërkuar për të garantuar huan (në vijim: *banka*);

- 1.3. **SRK** – nënkupton Sistemin e Regjistrimit Kontabël që mundëson emetimin, regjistrimin, shitjen dhe transferimin e tërësishëm në formë elektronike të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës;
- 1.4. **SPN** - nënkupton Sistemin e Pagesave Ndërbankare për shlyerje të pagesave në kohë reale;
- 1.5. **Letrat me vlerë të Qeverisë** - nënkupton letrat me vlerë të tregtueshme të emetuara nga Ministria e Financave dhe e Transfereve e Republikës së Kosovës, me të drejtën që të zotohen si kolateral kundrejt një huaje;
- 1.6. **Hua brenda-ditore për likuiditet** - nënkupton një hua të kolateralizuar që i ofrohet një banke nga ana e BQK-së, brenda orarit të punës së SPN, duke përdorur letrat me vlerë të Qeverisë si kolateral, kur bilanci i një banke në llogarinë e saj në BQK është i pamjaftueshëm për të procesuar urdhërat e pagesës;
- 1.7. **Hua njëditore për likuiditet** - nënkupton një hua të kolateralizuar, të zgjatur brenda natës për një bankë nga ana e BQK-së, me letrat e Qeverisë të përdorura si kolateral. Kjo hua mund të zgjatet nëse një bankë, për arsye teknike, nuk mund të shlyejë huan brenda-ditore për likuiditet gjatë orarit të punës së SPN të asaj dite kur është përcaktuar të bëhet kthimi i huas;
- 1.8. **Norma bazë e interesit** - nënkupton normën e riblerjes njëditore të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), referuar gjithashtu si norma marxhinale e huadhënies.
- 1.9. **Marzha e përcaktuar** - nënkupton shumën e përqindjes fikse të shtuar në normën bazë të interesit, ashtu siç do të përcaktohet nga BQK;
- 1.10. **Norma e interesit për hua njëditore për likuiditet** - nënkupton normën bazë të interesit plus normën e marzhës së përcaktuar nga BQK;
- 1.11. **Marrëveshja e Përgjithshme për Riblerje** - nënkupton marrëveshjen midis bankës dhe BQK-së me të cilën banka pranon t'i shesë BQK-së letrën ose letrat me vlerë me shumë specifike për një periudhë të caktuar kohore sipas Marrëveshjes për Riblerje dhe pranon të riblejë kolateralin në një datë të ardhshme sipas çmimit dhe afatit të maturimit të dakorduar nga të dy palët.

Neni 3

Hua brenda-ditore për likuiditet

1. Banka do të përdorë një hua brenda-ditore për likuiditet vetëm për të përmbushur nevojat ditore të likuiditetit për operacionet e saj të pagesave.
2. Në mënyrë që BQK të ofrojë një hua brenda-ditore për likuiditet një banke, banka do të iniciojë kërkesën përmes SRK duke lënë peng letra me vlerë të Qeverisë me një vlerë nominale që është së paku 110 përqind e shumës së huas.

3. Banka mund të kërkojë një ose më shumë hua brenda-ditore për likuiditet, megjithatë shuma e papaguar e huave brenda-ditore për likuiditet që do të ofrohen nga BQK nuk duhet të kalojë 30 përqind të kërkesës nga rezerva minimale e caktuar për bankën.
4. Çdo kërkesë individuale e iniciuar nga ndonjë prej bankave të kualifikuara do të autorizohet nga BQK, e cila mund të refuzojë kërkesën e bankës për hua brenda-ditore për likuiditet, në përputhje me objektivat e saj dhe pa asnjë arsytim.
5. Banka do të paguajë huan brenda-ditore për likuiditet me BQK-në në të njëjtën ditë pune duke e kthyer llogarinë për shlyerje në bilanc pozitiv, jo më vonë se deri tek afati i përcaktuar fillestar, ashtu siç është e përcaktuar në orarin operativ ditor të SPN.

Neni 4

Hua njëditore për likuiditet

1. Nëse një bankë nuk është në gjendje të kthejë huan brenda-ditore për likuiditet gjer në afatin e përcaktuar në nenin 3, paragrafi 5, të kësaj Rregulloreje, BQK-ja mund të zgjatë huan brenda ditore për likuiditet në mënyrë automatike në një hua njëditore për likuiditet për bankën në fjalë. BQK-ja do të përcaktojë shumën e saktë të huas që kërkohet për të sjellë llogarinë për shlyerje të bankës në një bilanc zero dhe pastaj ta rrumbullakojë atë shifër deri në shumëfishin më të afërt prej 10,000.00 Euro. Kjo llogaritje do të lejojë që operacioni në SPN të përmbyllet.
2. Huaja njëditore për likuiditet kërkon që BQK të marrë në zotërim të plotë dhe të përcaktojë shumën e nevojshme të kolateralit që fillimisht është ofruar nga banka, në përputhje me Marrëveshjen e Përgjithshme për Riblerje të nënshkruar me BQK. Pengu i kolateralit do të jetë vlera e së paku 110 përqind e shumës së huas përfundimtare. Transferimi i letrave me vlerë në posedim të BQK-së do të bëhet njëkohësisht me kreditimin e fondeve të mjaftueshme në llogarinë për shlyerje të bankës.
3. Marrëveshja standarde sipas së cilës BQK do të ofrojë një hua për likuiditet të kolateralizuar për bankat është e specifikuar në Marrëveshjen Kryesore të Përgjithshme për Riblerje.
4. Afati i maturimit të letrave me vlerë të lënë peng për hua likuiditeti të kolateralizuar duhet të jetë më i gjatë se afati i maturimit të huasë.
5. Me hapjen e sistemeve SRK dhe SPN dhe fillimit të ditës tjetër të punës, BQK do të kthejë në mënyrë automatike shumën e mbetur të huas, si dhe interesin e aplikueshëm, duke debituar llogarinë për shlyerje të bankës .
6. Një bankë nuk do të jetë në gjendje të procesojë operacionet e pagesave nga llogaria e saj për shlyerje derisa të paguhen të gjitha obligimet që rrjedhin nga huaja për likuiditet njëditor dhe llogaria për shlyerje e bankës të arrijë shumën e kërkesës për rezervën minimale të bilancit për atë ditë.

7. Shuma e një huaje të një ditore për likuiditet që do të ofrohet nga BQK, , nuk duhet të tejkalojë 30 përqind të kërkesës për rezervën minimale të një banke.
8. Norma e interesit për hua njëditore për likuiditet e cila do të aplikohet nga BQK-ja për hua njëditore për likuiditet, do të publikohet në faqen e internetit të BQK-së.

Neni 5

Shpeshtësia dhe Përfundimi

1. Bankat mund të përdorin huan brenda-ditore për likuiditet për të menaxhuar likuiditetin e tyre ditor dhe për t'i përmbushur nevojat operative.
2. Huaja njëditore për likuiditet mund të përdoret për rastet e çështjeve teknike me të cilat përballet një bankë, dhe e cila nuk mund të paguajë me kohë huan brenda-ditore për likuiditet. BQK-ja do të ndërmarr masat e nevojshme në rast së konstaton përsëritje të shpeshtë të kërkesës për hua njëditore për likuiditet që mund të vijë si rezultat i mos menaxhimit të duhur të çështjeve teknike nga ana e bankës të cilat ndikojnë në menaxhimin jo adekuat të likuiditetit dhe për pasoj ndikojnë në parashtrimin e kërkesës për hua një ditore për likuiditet.
3. BQK do të vlerësojë nëse mbështetja e vazhdueshme në këtë lehtësirë nga një bankë arsyeton vendosjen e tarifave shtesë ose ngarkesave apo edhe ndryshimin strukturor të funksionimit të operacioneve bankare të bankës.
4. BQK mund të pezullojë, kufizojë ose ndërpresë qasjen e një banke në huadhënien për likuiditet brenda-ditor dhe njëditor, nëse banka konsiderohet se paraqet rrezik për tregun.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 01 qershor 2020.

Flamur Mrasori

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës